



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2019
PËR KTHIMIN E TË HUAJVE ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIA) NO. 03/2019
ON RETURNING OF FOREIGNERS WITH ILLEGAL RESIDENT IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MUP) BR. 03/2019
O POVRATKU STRANACA KOJI ILEGALNO BORAVE U REPUBLICI KOSOVO

<p>Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,</p> <p>Në mbështetje të nenit 137, paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 dhe paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj (Gazeta Zyrtare Nr.35, e datës 05.09.2013) nenit 8, nënparagrafin 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011), nxjerr:</p>	<p>Minister of the Ministry of Internal Affairs,</p> <p>Pursuant to the Article 137, paragraph 1 sub-paragraph 1.6 and paragraph 5 of the Law No. 04/L-219 on Foreigners (Official Gazette No. 35, dated 05.09.2013) Article 8, sub-paragraph 1.4 of the Regulation No. 02/2011 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries, as well as Article 38, paragraph 6 of the Regulation No. 09/2011 on Rules and Procedure of the Government (Official Gazette No. 15, 12.09.2011), issues:</p>	<p>Ministar Ministarstva unutrašnjih poslova,</p> <p>Na osnovu člana 137. stav 1. tačka 1.6. i stav 5. Zakona br. 04/L-219 o strancima (Službeni list br. 35 od 5. 9. 2013), član 8. tačka 1.4. Pravilnika br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, kao i člana 38. stav 6. Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni list br. 15, 12. 9. 2011), izdanja:</p>
---	---	---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
(MPB) NR. 03/2019
PËR KTHIMIN E TË HUAJVE ME
QËNDRIM TË PALIGJSHËM NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ rregullon standardet dhe procedurat për kthimin e shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi të cilët nuk i përmbushin apo nuk i përmbushin më tej kushtet ligjore për qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin në fuqi për të Huaj dhe Azil, si dhe lehtësimin e kthimit vullnetar.

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION
(MIA) NO. 03/2019
ON RETURN OF FOREIGNERS
WITH ILLEGAL RESIDENCE IN
THE REPUBLIC OF KOSOVO**

**CHAPTER I
GENERAL PROVISIONS**

**Article 1
Purpose**

1. This Administrative Instruction regulates the standards and procedures for the return of foreign nationals and stateless persons who do not meet or no longer meet the legal requirements for staying in the territory of the Republic of Kosovo in accordance with the applicable law on foreigners and asylum, as well as facilitating voluntary return.

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO
(MUP) BR. 03/2019
O POVRATKU STRANACA KOJI
ILEGALNO BORAVE U
REPUBLICI KOSOVO**

**POGLAVLJE I
OPŠTE ODREDBE**

**Član 1
Svrha**

1. Ovim Administrativnim uputstvom se regulišu standardi i procedure za povratak stranih državljana i lica bez državljanstva koji ne ispunjavaju ili ne ispunjavaju dalje zakonske uslove za boravak na teritoriju Republike Kosovo, u skladu sa važećim Zakonom o strancima i azilu, kao i olakšavanje dobrovoljnog povratka.

<p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p>
<p>1. Përkufizimet e përdorura në Ligjin Nr.04/L-219 për të Huaj dhe Ligjin Nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-219 për të Huaj, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>2. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, përdoren edhe këto përkufizime:</p> <p>2.1. “Shteti kërkues”- nënkupton Republikën e Kosovës që paraqet kërkesë për ripranim apo për kalim transit tek shteti i huaj që kërkohet;</p> <p>2.2. “Shteti që i kërkohet”- nënkupton shtetin, të cilit Republika e Kosovës i paraqet kërkesë për ripranim apo për kalim transit;</p> <p>2.3. “Transit”- nënkupton kalimin e një të huaji apo personi pa shtetësi nëpërmjet territorit të shtetit që i kërkohet, nga territori i shtetit kërkues deri në vendin e destinacionit;</p> <p>2.4. “Vendim për kthim”- nënkupton një akt administrativ apo vendim gjyqësor me të cilin vërtetohet që qëndrimi i të huajit është i</p>	<p>1. Definitions used in the Law No. 04/L-219 on Foreigners and Law No. 06/L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-219 on Foreigners shall have the same meaning in the present Administrative Instruction as well.</p> <p>2. For purposes of the present Administrative Instruction, the following definitions shall be used as well:</p> <p>2.1. “Requesting country” shall mean the Republic of Kosovo submitting the request for readmission or transit to the requested country;</p> <p>2.2. “Requested country” shall mean the country to which the Republic of Kosovo submits a request for readmission or transit;</p> <p>2.3. “Transit” shall mean the transit of a foreigner or stateless person through the territory of requested country, from the territory of the requesting country to the country of destination;</p> <p>2.4. “Return decision” shall mean an administrative act or court decision whereby confirming that the residence of the foreigner is</p>	<p>1. Definicije koje se koriste u Zakonu br. 04/L-219 o strancima i Zakona br. 06/L-036 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-219 o strancima imaju isto značenje i u ovom Administrativnom uputstvu.</p> <p>2. U svrhu ovog Administrativnog uputstva koriste se i sledeće definicije:</p> <p>2.1. “Država koja zahteva” podrazumeva Republiku Kosovo koja podnosi zahtev za ponovni prijem ili tranzit do strane države koja zahteva;</p> <p>2.2. “Država od koje se zahteva” podrazumeva državu, kojoj je Republika Kosovo podnela zahtev ponovni prijem ili tranzit;</p> <p>2.3. „Tranzit” označava prolaz stranca ili lica bez državljanstva preko teritorije države of koje se zahteva sa teritorije države koja zahteva do zemlje odredišta;</p> <p>2.4. „Odluka o povratku” podrazumeva administrativni akt ili sudsku Odluku kojom se navodi da je boravak stranca ilegalan u</p>

<p>paligjshëm në Republikën e Kosovës dhe me të cilin vendoset se i njëjti duhet të kthehet;</p> <p>2.5. “Kthimi me forcë”- nënkupton ekzekutimin e detyrimit për kthim, përkatësisht transportimin fizik jashtë Republikës së Kosovës;</p> <p>2.6. “Ndalimi për hyrje”- nënkupton një akt administrativ apo vendim gjyqësor, që ndalon hyrjen dhe qëndrimin në territorin e Republikës së Kosovës, për një periudhë të caktuar, i cili mund të shqiptohet paralelisht me vendimin për kthim;</p> <p>2.7. “Rreziku për arratisje”- nënkupton ekzistencën e arsyeve në një rast të veçantë të bazuara në kritere objektive të përcaktuara në ligj, të cilat të bëjnë të besosh se i huaji i cili është subjekt i procedurave të kthimit do të arratiset për t'ju shmangur kthimit;</p> <p>2.8. “Kthimi vullnetar”- nënkupton pajtimin me obligimin për kthim brenda afatit kohor të caktuar në vendimin për kthim;</p> <p>2.9. “Vendim i lirë”- nënkupton shprehjen e vullnetit për kthim nga i huaji në mungesë të çfarëdo presioni fizik apo psikik dhe bazuar në një gatishmëri të mjaftueshme të informatave të sakta dhe objektive mbi të cilat e bazon</p>	<p>illegal in the Republic of Kosovo and deciding that the same has to be returned;</p> <p>2.5. “Forced return” shall mean the execution of return obligation, namely physical transport outside the Republic of Kosovo;</p> <p>2.6. “Entry ban” shall mean an administrative act or court decision that bans the entrance and residence in the territory of the Republic of Kosovo for a specific time period which can be imposed simultaneously with the decision to return;</p> <p>2.7. “Risk of escape” shall mean the existence of reasons in a special case based on the objective criteria determined by law, which make you believe that the foreigner who is a subject of return procedures will escape to avoid return;</p> <p>2.8. “Voluntary return” shall mean compliance with the obligation to return within the deadline set in the decision for return;</p> <p>2.9. “Free decision” means expressing the willingness to return by a foreigner in the absence of any physical or psychological pressure and based on a sufficient readiness of the precise and objective information on which</p>	<p>Republici Kosovo i kojim se donosi odluka da se isti treba vratiti;</p> <p>2.5. „Prisilni povratak” podrazumeva izvršenje obaveze povratka, odnosno fizičkog prevoza van Republike Kosovo;</p> <p>2.6. „Zabrana ulaska” podrazumeva administrativni akt ili sudsku Odluku, kojom se zabranjuje ulazak i boravak na teritoriji Kosova, u određenom vremenskom periodu, koja može biti izrečena istovremeno sa odlukom o povratku;</p> <p>2.7. „Rizik od bekstva” podrazumeva postojanje razloga u konkretnom slučaju na osnovu objektivnih kriterijuma utvrđenih zakonom, koji čine da verujemo da će stranac, koji je predmet postupka povratka, pobeći kako bi izbegao vraćanje;</p> <p>2.8. „Dobrovoljni povratak” podrazumijeva saglasnost sa obavezom da se vrati u roku određenom u odluci o povratku;</p> <p>2.9. „Slobodna odluka” podrazumeva izražavanje spremnosti stranca da se vrati u odsustvu bilo kakvog fizičkog ili psihološkog pritiska i zasnovan na dovoljnoj spremnosti preciznih i objektivnih informacija kojima se</p>
--	---	--

<p>vendimin.</p> <p>2.10. “Persona të cenueshëm”- nënkupton të miturit, të miturit e pashoqëruar, njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë shtatzëna, prindërit të vetëm me fëmijë të mitur dhe personat të cilët kanë qenë subjekt i torturës, dhunimit apo formave tjera serioze të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale duke mos u kufizuar vetëm në këto.</p> <p>2.11. “KAVR” – nënkupton kthimin e asistuar vullnetar dhe riintegrimin, kthimi i asistuar vullnetar dhe riintegrimi përfshijnë asistencën logjistike dhe financiare për kthim, si dhe masat riintegruese që ofrohen individit për kthim vullnetar kurdo që kjo e fundit është e mundur.</p> <p>2.12. “Asistimi në riintegrim” - nënkupton ndihmën që i ofrohet individit pas kthimit të tij në vendin e origjinës.</p> <p>2.13. “DSHAM”- nënkupton Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.</p> <p>2.14. “DRK” –nënkupton Divizionin për Ripranim dhe Kthim;</p>	<p>the decision is based.</p> <p>2.10. “Vulnerable persons” shall mean, but not limited to minors, unaccompanied minors, persons with disabilities, elderly people, pregnant women, single parents with minors, and persons subjected to torture, rape or other serious forms of psychological, physical or sexual violence.</p> <p>2.11. AVRR – shall mean Assisted Voluntary Return and Reintegration, which includes logistical and financial assistance for return, and reintegration measures provided to the individual for voluntary return, whenever possible.</p> <p>2.12. Assistance for reintegration – shall mean the assistance provided to the individual following his return to the country of origin.</p> <p>2.13. “DCAM” - shall mean the Department for Citizenship, Asylum and Migration within the Ministry of Internal Affairs.</p> <p>2.14. “DRR” - shall mean the Division for Readmission and Return;</p>	<p>zasniva odluka.</p> <p>2.10. „Ugrožena lice” podrazumeva maloletnika, maloletnika bez pratnje, osobe sa ograničenim sposobnostima, starije osobe, trudnice, samohrane roditelji sa maloletnom decom i lica koja su bila podvrgnuta mučenju, silovanju ili drugim oblicima teškog psihičkog, fizičkog ili seksualnog nasilja, ne ograničavajući se samo na ovo.</p> <p>2.11. PDPR – podrazumeva pomognuti dobrovoljni povratak i reintegraciju, pomognuti dobrovoljni povratak i reintegraciju obuhvataju logističku i finansijsku pomoć za povratak, kao i mere reintegracije koje se nude pojedincu za dobrovoljni povratak kadgod je ovo poslednje moguće.</p> <p>2.12. Pomoć za reintegraciju– podrazumeva pomoć pruženu pojedincu nakon povratka u zemlju porekla.</p> <p>2.13. „DDAM” podrazumeva Departman za državljanstvo, azil i migracije u okviru Ministarstva unutrašnjih poslova.</p> <p>2.14. DRP– Odeljenje za redmisiju i povratak;</p>
--	---	---

<p>2.15. “DMH” - nënkupton Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë së Kosovës;</p> <p>2.16. “ILECU”- nënkupton Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit në kuadër të Policisë së Kosovës.</p>	<p>2.15. “DMF” – shall mean the Directory for Migration and Foreigners within Kosovo Police;</p> <p>2.16. ILECU – shall mean the Directorate of International Cooperation in the Field of Law Enforcement within Kosovo Police.</p>	<p>2.15. „DMS” podrazumeva Direkciju za migracije i strance u Kosovskoj policiji;</p> <p>2.16. ILECU – podrazumeva Direkciju za međunarodnu saradnju u oblasti sprovođenja zakona u okviru Kosovske policije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Fushëveprimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Delokrug</p>
<p>1. Ky Udhëzim Administrativ është i zbatueshëm për kategoritë e të huajve të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme si në vijim:</p> <p>1.1. Të huajve të cilët tejkalojnë afatin e lejes për qëndrim apo të cilëve iu është refuzuar, apo revokuar leje qëndrimi sipas Ligjit nr.04/L- 219 për të Huaj apo Ligjit Nr. 06//L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huaj;</p> <p>1.2. Të huajt të cilët nuk plotësojnë kushtet për qëndrim, duke përfshirë ndërprerjen dhe anulimin e qëndrimit afatshkurtër sipas Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe Ligjit Nr. 06//L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huaj;</p>	<p>1. The present Administrative Instruction shall apply to the categories of foreigners illegally residing in the territory of the Republic of Kosovo, as follows:</p> <p>1.1. Foreigners who exceed the deadline of residence permit or whose residence permit has been refused or revoked according to the Law No. 04/L219 on Foreigners or Law No. 06/L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-219 on Foreigners;</p> <p>1.2. Foreigners who do not fulfil conditions for residence, including suspension and cancellation of short-term residence, pursuant to the Law No. 04/L-219 on Foreigners and Law No. 06/L-036 on amending and supplementing the Law No.</p>	<p>1. Ovo Administrativno uputstvo se primenjuje na kategorije stranaca koji ilegalno borave na teritoriji Republike Kosovo, kao u nastavku:</p> <p>1.1. Stranci koji premašuju trajanje boravišne dozvole ili kojima je boravišna dozvola odbijena ili povučena u skladu sa Zakonom br. 04/L-219 o strancima ili Zakonom br. 06/L-036 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-219 o strancima;</p> <p>1.2. Stranci koji ne ispunjavaju uslove za boravak, uključujući prekid i ukidanje kratkoročnog boravka u skladu sa Zakonom br. 04/L-219 o strancima i zakonom br. 06/L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima;</p>

<p>1.3. Të huajve të cilëve iu ka përfunduar leja për qëndrim në rast të revokimit të statusit të refugjatit, të mbrojtjes plotësuese apo statusit të personit pa shtetësi;</p> <p>1.4. Aplikuesve të cilëve me vendim të formës së prerë u refuzohet apo ndërpritet procedura për përcaktim të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.</p> <p>1.5. Të huajve të cilëve me vendim gjyqësor u shqiptohet dënimi për dëbimin e tyre nga territori i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6. Aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe personave me status refugjati të cilët vendosin të kthehen në mënyrë vullnetare në shtetin e origjinës apo në ndonjë shtet të tretë ku kanë shtetësi.</p> <p>2. Ky Udhëzim Administrativ nuk zbatohet për të huajt të cilët janë:</p> <p>2.1. Subjekt i refuzimit të hyrjes në Republikën e Kosovës sipas nenit 31 Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe nenit 4 Ligjit Nr. 06//L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huaj;</p> <p>2.2. Subjekt i procedurës së ekstradimit sipas</p>	<p>04/L-219 on Foreigners;</p> <p>1.3. Foreigners whose residence permit has expired in case of revocation of refugee status, subsidiary protection or status of a stateless person;</p> <p>1.4. Applicants, whose procedure for determining the status of international protection is refused or terminated with a final decision.</p> <p>1.5. Foreigners against whom a sentence for their departure from the Republic of Kosovo is imposed with a court decision;</p> <p>1.6. Applicants for international protection and persons with the status of refugee, who decide to voluntarily return to the country of origin or any other third country in which they have citizenship.</p> <p>2. The present Administrative Instruction shall not apply to foreigners, who are:</p> <p>2.1. subject to rejection of entrance pursuant to Article 31 of the Law No. 04/L-219 on Foreigners and Article 4 of the Law No. 06//L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-219 on Foreigners;</p> <p>2.2. subject to the extradition procedure</p>	<p>1.3. Strancima kojima je istekla boravišna dozvola u slučaju ukidanja statusa izbeglice, dopunske zaštite ili statusa lica bez državljanstva;</p> <p>1.4. Podnosiocima zahteva kojima je konačnom odlukom odbijen ili ukinut postupak utvrđivanja statusa međunarodne zaštite.</p> <p>1.5. Stranci kojima je sudskom Odlukom izrečena kazna za njihovog proterivanja sa teritorije Republike Kosovo;</p> <p>1.6. Podnosioci zahteva za međunarodnu zaštitu i osobe sa statusom izbjeglice koji odluče da se dobrovoljno vrata u zemlju porekla ili u bilo koju treću zemlju čiji su državljani.</p> <p>2. Ovo Administrativno Uputstvo se ne odnosi na strance koji su:</p> <p>2.1. Predmet odbijanja ulaska u Republiku Kosovo u skladu sa članom 31. Zakona br. 04/L-219 o strancima i članom 4. Zakona br. 06/L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima;</p> <p>2.2. Predmet postupka izručivanja u skladu</p>
---	--	--

<p>legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Dispozitat më të favorshme</p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ nuk çënon dispozitat më të favorshme të parashikuara në marrëveshjet dypalëshe apo shumpalëshe të nënshkruara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe një apo disa shteteve të tjera.</p> <p>2. Të huajt të cilët nuk bien në fushën e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ sipas paragrafit 2, nënparagrafi 2.1, të nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, organi kompetent duhet të respektoj që:</p> <p>2.1. Trajtimi dhe niveli i mbrojtjes nuk duhet të jetë më pak i favorshëm se ai i paraparë në paragrafin 6,8 dhe 9 të nenit 94 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huaj, si dhe nenit 31 të Ligjit nr. 06//L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huaj, nenit 107,108,112,113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj, si dhe nenit 38 dhe 39 Ligjit nr. 06//L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huaj, si dhe nenit 7 paragrafi 4, nenit 8 dhe 9 të këtij Udhëzimi Administrativ;</p>	<p>pursuant to the relevant legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 More favourable provisions</p> <p>1. This Administrative Instruction shall not forbid more favourable provisions provided for in the bilateral or multilateral agreements signed between the Republic of Kosovo and one or more other states.</p> <p>2. As to foreigners who do not fall under the scope of the present Administrative Instruction under paragraph 2, sub-paragraph 2.1 of Article 3 of the present Administrative Instruction, the competent authority shall ensure that:</p> <p>2.1. Treatment and level of protection is not less favourable than that provided for in paragraph 6, 8 and 9 of Article 94 of the Law No. 04/L-219 on Foreigners and Article 31 of the Law No. 06//L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-219 on Foreigners, Article 107, 108, 112, 113 and 114 of the Law No. 04/L-219 on Foreigners and Article 38 and 39 Law No. 06//L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-219 on Foreigners, as well as Article 7 paragraph 4, Article 8 and 9 of this Administrative Instruction;</p>	<p>sa odgovarajućim važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Najpovoljnije odredbe</p> <p>1. Ovo Administrativno uputstvo ne utiče na najpovoljnije odredbe predviđene bilateralnim i multilateralnim sporazumima potpisanim između Republike Kosova i jedne ili više drugih država.</p> <p>2. Stranci koji ne spadaju u delokrug ovog Administrativnog uputstva iz tačke 2.1 člana 3. ovog Administrativnog uputstva, nadležni organ trebaju poštovati da:</p> <p>2.1. Tretman i nivo zaštite ne bi trebalo biti manje povoljan od onog predviđenog u stavovima 6, 8. i 9. člana 94. Zakona br. 04/L-219 o strancima, kao i člana 31. Zakona br. 06/L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima, članovima 107, 108, 112, 113. i 114. Zakona br. 04/L-219 o strancima, kao i članovima 38. i 39. Zakona br. 06/L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima, kao i člana 7. stav 4, članova 8. i 9. ovog Administrativnog uputstva;</p>
---	--	--

2.2. Të respektohet parimi i moskthimit.

**KAPITULLI II
PËRFUNDIMI I QËNDRIMIT TË
PALIGJSHËM**

**Neni 5
Vendimi për kthim**

1. Vendimi për largim vullnetar apo vendimi për largim me forcë, merret për çdo të huaj i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës, pa cënuar të drejtën e parashikuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Divizioni për të Huaj mund t'i lëshoj një të huaji që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës, një leje për qëndrim e cila lejon qëndrimin për arsye humanitare. Në rast se është marrë vendimi për largim vullnetar apo me forcë, i njëjti duhet të revokohet apo pezullohet në përputhje me afatin që është dhënë leja për qëndrim.

3. Nëse i huaji i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës është subjekt i një procedure për vazhdimin e lejeqëndrimit apo autorizimit që i

2.2. the principle of non-refoulement is observed.

**CHAPTER II
END OF ILLEGAL RESIDENCE**

**Article 5
Decisions for return**

1. The decision for voluntary departure or decision for forced departure shall be taken for each foreigner illegally residing in the territory of the Republic of Kosovo, without infringing the right provided for in paragraphs 2 and 3 of this Article.

2. Division for Foreigners may grant to a foreigner illegally residing in the territory of the Republic of Kosovo a residence permit whereby permitting the residence for humanitarian reasons. In case a decision for voluntary or forced departure has been taken, the same shall be revoked or suspended in compliance with the validity period of residence permit.

3. If a foreigner illegally residing in the territory of the Republic of Kosovo is subject to a procedure for extending the residence permit or that gives the right to stay in the territory of the

2.2. Da se poštuje načelo nevraćanja.

**POGLAVLJE II
ZAVRŠETAK ILEGALNOG BORAVKA**

**Član 5
Odluka opovratku**

1. Odluka o dobrovoljnom odlasku ili odluka o prisilnom proterivanju će se doneti protiv svakog stranca koji nezakonito boravi na teritoriji Republike Kosova, bez kršenja prava iz stavova 2 i 3 ovog člana.

2. Divizija za strance može izdati strancu koji nezakonito boravi na teritoriji Republike Kosova, boravišnu dozvolu koja odobrava boravak iz humanitarnih razloga. Ako je doneta odluka o dobrovoljnom odlasku ili prisilnom proterivanju, ona mora biti poništena ili obustavljena u skladu sa vremenskim periodom za koji je izdata boravišna dozvola.

3. Ako stranac koji nezakonito boravi na teritoriji Republike Kosovo, podleže postupku za produženje boravišne dozvole ili ovlašćenja kojim mu se daje pravo boravka na teritoriji

<p>jep të drejtën të qëndroj në territorin e Republikës së Kosovës, Divizioni për të Huaj konstaton nëse është e mundur të mos nxjerrë vendim për largim vullnetar deri në përfundimin e procedurës së lartpërmendur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Kthimi vullnetar</p> <p>1. Vendimi për largim vullnetar lëshohet nga Divizioni për të Huaj në këto raste:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Refuzimi i kërkesës për leje qëndrim;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Revokimi i leje qëndrimit.</p> <p>2. Vendimi për largim vullnetar lëshohet nga DMH-ja, përjashtimisht rasteve të përcaktuara në paragrafin një (1) të këtij neni. Në rast të moszbatimit të vendimit vullnetar, DMH-ja nxjerr vendim për largim me forcë.</p> <p>3. Divizioni për të Huaj dhe DMH-ja parashikojnë një afat të caktuar kohor të përshtatshëm për kthim vullnetar të huajit nga shtatë (7) deri në tridhjetë (30) ditë, pa cënuar dispozitat e paragrafit katër (4) dhe gjashtë (6) të këtij neni. Divizioni për të Huaj menjëherë e njofton DMH-në për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit për largim vullnetar.</p>	<p>Republic of Kosovo, the Division for Foreigners determines whether it is possible not to decide on the voluntary departure until completion of the abovementioned procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Voluntary return</p> <p>1. The Decision for voluntary return shall be issued by the Division for Foreigners in the following cases:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Refusal of request for residence permit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Revocation of residence permit.</p> <p>2. The Decision for voluntary return shall be issued by DMF, except in cases set out in paragraph one (1) of this article. In case the Decision for voluntary decision is not complied with, DMF shall issue a Decision for forced return.</p> <p>3. Division for Foreigners and DMF provide for a certain time period appropriate for voluntary return of the foreigner seven (7) to thirty (30) days, without infringing the provisions contained in paragraph four (4) and six (6) of this article. Division for Foreigners shall immediately inform DMF for supervising the enforcement of the Decision for voluntary</p>	<p>Republike Kosovo, Divizija za strance utvrđuje, ako je to moguće da se ne donosi odluka o dobrovoljnom odlasku do kraja gore pomenutog postupka.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Dobrovoljnipovratak</p> <p>1. Odluku odobrovoljnom odlasku izdaje Divizija za stranceu sledećim slučajevima:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Odbijanje zahteva zaboravišnom dozvolom;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Ukidanje boravišne dozvole.</p> <p>2. Nalog za dobrovoljno vraćanje izdaje DMS, izuzev slučajevanavedenih ustavu jedan (1) ovog člana. U slučaju nesprovođenjadobrovoljne odluke, DMS izdaje odluku zaprisilno proterivanje.</p> <p>3. Divizija za strance i DMS obezbeđuju odgovarajući vremenski rok za dobrovoljnovraćanje stranca od sedam (7) do trideset (30) dana, bez povredeodredaba stava četiri (4) i šest (6) ovogčlana. Divizija za strance odmah obaveštava DMS o praćenju sprovođenja Odluke o dobrovoljnom odlasku.</p>
--	--	---

<p>4. Divizioni për të Huajt me marrjen e vendimit mund ta zgjasë afatin kohor për kthim vullnetar të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të të huajt sipas nenit 94, paragrafin 6 të Ligjit nr. 04/L – 219 për të Huajt.</p> <p>5. Për të zvogëluar rrezikun e arratisjes, DMH-ja, mund t'i kërkoj të huajt të paraqitet rregullisht pranë sajë, të bëjë depozitim të një shume financiare, dorëzimin e dokumenteve, si dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar për periudhën që i paraprinë kthimit vullnetar.</p> <p>6. Nëse ekziston rreziku i arratisjes, nëse kërkesa për leje qëndrim është refuzuar si dukshëm e pabazuar apo është bërë me qëllim të mashtrimit, apo nëse i huaji përbën rrezik për rendin publik dhe sigurinë e brendshme, të huajt nuk i jepet afat për kthim vullnetar i paraparë në paragrafin tre (3) të këtij neni, ose mund t'i jepet një afat më i shkurtër se afati prej shtatë (7) ditëve, i paraparë në paragrafin tre (3) të këtij neni.</p> <p>7. Me vendimin për largim vullnetar, të huajt mund t'i shqiptohet edhe ndalimi i hyrjes në afat prej një (1) muaj deri në pesë (5) vite.</p>	<p>return.</p> <p>4. Division for Foreigners may extend in the decision the time period for voluntary return provided for in paragraph 1 of this article, considering specific circumstances of the foreigner according to Article 94, paragraph 6 of the Law No. 04/L-219 on Foreigners.</p> <p>5. To reduce the risk of escape, DMF can ask the foreigner to appear regularly before it, deposit a certain amount of money, submit documents and oblige him to stay in a certain place for the period awaiting the voluntary return.</p> <p>6. If there is a risk of escape, if the request for permission was rejected as manifestly unfounded or made with intent to defraud, or if the foreigner constitutes a threat to public order and internal security, the foreigner shall not be granted a deadline for voluntary return referred to in paragraph three (3) of this article or may be granted a time period shorter than seven (7) days as foreseen in paragraph three (3) of this article.</p> <p>7. The Decision for voluntary return may impose the entry ban for the period of one (1) month up to five (5) years.</p>	<p>4. Divizija za strance donošenjem odluke može produžiti rok za dobrovoljnovraćanje iz stava 1. ovog člana, uzimajući u obzir specifične okolnosti stranca u skladu sa članom 94. stav 6. Zakona br. 04 / L - 219 o strancima.</p> <p>5. Da bi se smanjio rizik od bekstva, DMS može zatražiti od stranca da se redovno javlja u njenim prostorijama, da vršideponovanjeodređenog iznosa finansijskih sredstava, da dostavlja dokumenta kao iobavezu boravka u određenom mestu za period koji prethodi dobrovoljnomvraćanju.</p> <p>6. Ako postoji rizik od bekstva, ako je zahtev za izdavanje boravišne dozvole odbijen kao očigledno neosnovan ili je podnet u cilju prevare, ili ako stranac predstavlja opasnosti po javni red i unutrašnjubezbednost, strancu se ne odobrava rok za dobrovoljnovraćenavedeno ustavu (3) ovog člana ili mu se odobri kraći rok od roka od sedam (7) dana predviđenim stavom tri (3) ovog člana.</p> <p>7. Odlukom o dobrovoljnom odlasku strancu se može izreći zabrana ulaska za period od jednog (1) meseca do pet (5) godina.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 7 Kthimi me forcë</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Forced return</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Prisilnipovratak</p>
<p>1. Vendimi për largim me forcë lëshohet nga DMH.</p> <p>2. Çdo herë vendimi për largim me forcë duhet të përmbajë edhe afatin e ndalimit të hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës prej një (1) muaj deri në pesë (5) vite.</p> <p>3. DMH duhet të merr masat e nevojshme me qëllim që të garantojë ekzekutimin e vendimit për largim me forcë në rastet kur nuk është respektuar vendimi për kthim vullnetar.</p> <p>4. Në rast të kthimit me forcë të një të huaji i cili nuk dëshiron të largohet, DMH përdor masat në mënyrë proporcionale me qëllim të mos tejkalimit të paarsyeshëm të forcës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe respektimin e të drejtave themelore duke i kushtuar respekt adekuat dinjitetit dhe integritetit fizik të huajit.</p> <p>5. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ në rast të refuzimit apo revokimit të lejeqëndimit për të huajin i cili paraqet rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik, DMH-ja nxjerr vendim për Largim me Forcë.</p>	<p>1. The decision for forced departure shall be issued by DMF.</p> <p>2. In each case, the decision for forced departure shall also contain the period of entry ban in the territory of the Republic of Kosovo from one (1) month to five (5) years.</p> <p>3. DMF shall take necessary measures in order to guarantee the execution of the decision for forced departure in cases when the decision for voluntary return has not been complied with.</p> <p>4. In cases of forced departure of a foreigner who does not want to return, DMF uses measures in proportional manner in order not to overuse force and in accordance with the legislation in force, as well as respecting fundamental rights, while giving adequate respect to the dignity and physical integrity of the foreigner.</p> <p>5. Notwithstanding paragraph 2 of Article 6 of the present Administrative Instruction, in case of refusal or revocation of the residence permit for the foreigner who poses a risk to public order, state security or public health, DMF shall issue a decision for forced departure.</p>	<p>1. Odluku oprisilnom povratku izdaje DMS.</p> <p>2. Odluka o prisilnom proterivanju uvek mora sadržati i rok zabrane ulaska na teritoriju Republike Kosovo za period od jednog (1) meseca do pet (5) godina.</p> <p>3. DMS treba da preduzme neophodne mere kako bi garantovao izvršenje Odluke o prisilnom proterivanju u slučajevima kada odluka o dobrovoljnom povratku nije poštovana.</p> <p>4. U slučaju prisilnog povratka stranca koji ne želi da ode, DMS koristi proporcionalne mere sa ciljem da se nerazumno ne prevaziđe upotreba sile iu skladu sa važećim zakonima, kao i poštovanje osnovnih prava uz adekvatnopoštovanje dostojanstva i fizičkog integriteta stranca.</p> <p>5. Izuzetno iz stava 2 člana 6 ovog Administrativnog uputstva u slučaju odbijanja ili ukidanja boravišne dozvole strancu koji predstavlja opasnostpo javni red, državnu bezbednost ili javno zdravlje, DMS donosi odluku o prisilnom proterivanju.</p>

<p>6. Përjashtimisht paragrafit 2 të këtij neni, në rast se të huajt kanë pasur lejeqëndrim mbi bazën e arsyes humanitare si viktima të trafikimit me njerëz apo kontrabandës me migrantë, e të cilët kanë bashkëpunuar me autoritetet kompetente sipas nenit 41 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, nuk u shqiptohet ndalesa e hyrjes në vendimin për largim me forcë, si rezultat i mospërmbushjes së afatit për kthim vullnetar siç është përcaktuar në nenin 6, paragrafin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>7. Institucioni i Avokatit të Popullit ka të drejtë të monitorojë procedurat e kthimit me forcë, monitorimi nga Avokati i popullit bëhet sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Shtyerja e kthimit me forcë</p> <p>1. Ekzekutimi i vendimit për largim më forcë, shtyhet në rastet si më poshtë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Nëse çënohet parimi i moskthimit ose kur është pezulluar ekzekutimi i kthimit në</p>	<p>6. Notwithstanding paragraph 2 of this article, in case when the foreigner have had residence permit on the basis of humanitarian grounds as victims of human trafficking, or smuggling of migrants, and who have cooperated with the competent authorities according to Article 41 on Law No. 04/L-219 on Foreigners and Article 7 of the Law No. 06/L-036 on amending and supplementing the Law No. 04/L-2019 on Foreigners, no entry ban shall be imposed in the decision for forced departure as a result of failure to comply with the deadline for voluntary return, provided for in paragraph 1 of Article 6 of the present Administrative Instruction.</p> <p>7. Institution of Ombudsperson shall be entitled to monitor forced return procedures. This monitoring by the Ombudsperson shall take place pursuant to the Law on Ombudsperson.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Delaying forced departure</p> <p>1. The enforcement of the decision for forced departure shall be delayed in the following cases:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. where the principle of non-refoulement is violated or when the execution of</p>	<p>6. Izuzetno stavu 2 ovog člana, ako je strancima izdata boravišna dozvola na humanitarnim osnovama, kao žrtve trgovine ljudima ili krijumčarenja imigrantima, koji su saradivali sa nadležnim organima prema članu 41 Zakona br. 04 / L-219 o strancima i članu 7 Zakona br. 06 / L-036 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima, u odluci o prinudnom proterivanju neće im biti izrečena zabrana ulaska kao rezultat neispunjavanjaroکا dobrovoljnog povratka, kao što je propisano u članu 6, stav 3 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>7. Institut Ombudsmana ima pravo da nadgleda procedure prinudnog proterivanja, nadgledanje od strane Ombudsmana vrši se u skladu sa Zakonom o Ombudsmanu.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Odlaganje prisilnog proterivanja</p> <p>1. Izvršenje odluke oprisilnom proterivanju, može se odložiti u sledećim slučajevima:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Ako je povređen princip nepovratka ili kada je obustavljeno izvršenje povratka u</p>
--	---	--

<p>përputhje me nenin 1,1 paragrafi 1 dhe 2 të këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p>1.2. Kur gjendja mendore ose fizike e të huajit e bënë të pamundur kthimin e tij;</p> <p>1.3. Për arsye teknike, si mungesa e transportit apo pamundësia për të vërtetuar identitetin e të huajit.</p> <p>2. Në rast të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit për largim me forcë, mund të zbatohen detyrimet e parashikuara në nenin 6, paragrafin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Kthimi vullnetar dhe kthimi me forcë i një fëmije të pashoqëruar</p> <p>1. Para vendosjes për marrjen e vendimit për kthim për fëmion e pashoqëruar, DMH-ja kërkon nga Qendra për Punë Sociale (QPS-ja) e komunës përkatëse të caktohet kujdestari ligjor, i cili do ta përfaqësoj dhe shoqëroj të miturin deri në kthimin e tij në vendin e origjinës apo prejardhjes.</p> <p>2. Para marrjes së vendimit për kthim të</p>	<p>departure is suspended in accordance with paragraph 1 and 2 of Article 12 of the present Administrative Instruction;</p> <p>1.2. where the mental or physical condition of the foreigner makes his departure impossible;</p> <p>1.3. for technical reasons, such as lack of transportation or inability to verify the identity of the foreigner.</p> <p>2. In case of a delay of execution of a decision for forced departure, obligations determined in paragraph 5 of Article 6 of the present Administrative Instruction shall apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Voluntary return or forced return of an unaccompanied child</p> <p>1. Before taking the decision for voluntary return, DMF shall request from the Centre for Social Work (CSW) of the relevant municipality to determine the legal guardian, who will represent and accompany the juvenile in his return to the country of origin.</p> <p>2. Before taking the decision for return of</p>	<p>skladu sa članom 11. stav 1. i 2. ovog Administrativnog uputstva</p> <p>1.2. Kada mentalno i fizičko zdravljestrancačininjegov/njen povratak nemogućim;</p> <p>1.3. Iz tehničkih razloga, kao što je nedostatak transporta ili nemogućnost dokazivanja identiteta stranca.</p> <p>2. U slučaju odlaganja izvršenja odluke o prisilnom proterivanju, mogu se primeniti obaveze predviđene članom 6. stav 5. ovog Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Dobrovoljnipovratak i prisilnoproterivanje deteta bez pratnje</p> <p>1. Prije odlučivanja o donošenju odlukeza vraćanjedeteta bez pratnje, DMS zahteva od Centra za socijalni rad (CSR) odgovarajuće opštine da imenuje pravnog staratelja koji će zastupati i pratiti maloletnika do njegovog povratka u zemlju porekla.</p> <p>2. Pre donošenja odluke o povratku dece bez</p>
--	--	--

<p>fëmijëve të pashoqëruar, DSHAM duhet të verifikoj dhe të sigurohet se fëmija do t'i dorëzohet prindërve të tij/saj, kujdestarit ligjor apo strukturave kompetente të vendit ku do të kthehet fëmija i pashoqëruar.</p>	<p>unaccompanied children, DCAM must verify and ensure that the child is handed over to his/her parents, legal guardian or competent structures in the country where the unaccompanied child is to be returned.</p>	<p>pratnje, DDAM mora proveriti i osigurati da će dete biti predato njegovim/njenim roditeljima, pravnom staratelju ili nadležnim organima zemlje u kojoj će dete biti vraćeno bez pratnje.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI III GARANCITË PROCEDURALE</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III PROCEDURAL GUARANTEES</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE III PROCEDURALNE GARANCIJE</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Forma e vendimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Form of decision</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Obrazac odluke</p>
<p>1. Vendimi për largim vullnetar dhe vendimi për largim me forcë lëshohet me shkrim, duke përmendur arsyet faktike dhe juridike për lëshimin e tyre, si dhe këshillën juridike për ankesë dhe procedurën e ankimit. Dhënia e arsyeve faktike mund të kufizohet me qëllim të ruajtjes së sigurisë dhe të rendit publik, si dhe për parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale.</p> <p>2. Organi kompetent do të ofrojë, në rast se kërkohet nga i huaji, një përkthim të shkruar apo verbal të elementeve kryesore të vendimit lidhur me kthimin, siç është referuar në paragrafin 1 të këtij neni, përfshirë informacionet për mjetet juridike në dispozicion në një gjuhë që e kupton apo të cilën në mënyrë të arsyeshme mund të prezumohet se e kupton.</p> <p>3. Detyrimi i paraparë në paragrafin 2 të këtij</p>	<p>1. The decision for voluntary departure and forced departure order shall be issued in writing, citing the factual and legal reasons for their issuance and the legal advice for complaint and appealing procedure. Giving factual reasons may be limited in order to maintain security and public order, as well as for the prevention, investigation and detection of criminal offenses.</p> <p>2. The competent body shall provide, upon the request of a foreigner, a written or verbal translation of main elements of the decision related to the return, as referred in paragraph 1 of this article, including information on legal remedies available in a language that a foreigner understands, or is reasonably presumed that understands.</p> <p>3. The obligation provided for in paragraph 2 of</p>	<p>1. Odluka o dobrovoljnom odlasku i odluka o prisilnomproterivanju izdaju se na pismen način, navodeći činjenične i pravne razloge za njihovo izdavanje, kao i pravni savet za žalbu i žalbeni postupak. Pružanje činjeničnih razloga može se ograničiti da bi se zaštitila javna bezbednost i red, kao i za sprečavanje, istragu i otkrivanje krivičnih dela.</p> <p>2. Nadležniorgan će, ako to zahteva stranac, obezbediti pismeni ili usmeni prevod ključnih elemenata odluke koji se odnose na vraćanje iz stava 1 ovog člana, uključujući i informacije o pravnim lekovima dostupnim na jeziku koji razume ili se razumno može očekivati da bi je razumeo.</p> <p>3. Obaveza propisana u stavu 2. ovog člana</p>

<p>neni, nuk zbatohet nëse i huaji që duhet të kthehet ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës dhe nuk ka marrë leje për qëndrim.</p> <p>4. Vendimi për largim vullnetar i nxjerrë nga Divizioni për të Huaj, Drejtorja për Migrim dhe të Huaj si dhe vendimi për largim me forcë nxirret në formë standarte.(Shih shtojcën 1A; 1B dhe shtojcën 2 të këtij Udhëzimi Administrativ).</p>	<p>this article shall not apply if the foreigner to be returned has entered illegally in the territory of the Republic of Kosovo and has not taken a residence permit.</p> <p>4. The decision for voluntary return issued by the Division for Foreigners, Directory for Migration and Foreigner, and the decision for forced departure, shall be issued in the standard form. (See Annex 1A, 1B and Annex 2 of the present Administrative Instruction).</p>	<p>neće se primenjivati ako je stranac koji se vraća ušao na ilegalan način na teritoriju Republike Kosovo i nije dobio boravišnu dozvolu.</p> <p>4. Odluka o dobrovoljnom odlasku koju je izdala Divizija za strance, Direkcija za migraciju i strance, kao i Odluka o prisilnom proterivanju izdaju se u standardnom obrascu (vidi Aneks 1A, 1B i Aneks 2 ovog Administrativnog Uputstva).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 E drejta e ankesës</p> <p>1. I huaji ka të drejtë ankese kundër vendimit për largim vullnetar brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të vendimit të largimit vullnetar në Komisionin e Ankesave.</p> <p>2. Komisioni shqyrton ankesën brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit për largim vullnetar e pezullon ekzekutimin e vendimit.</p> <p>3. Komisioni duhet ta zgjidh qështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit për largim vullnetar e pezullon ekzekutimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Right to appeal</p> <p>1. A foreigner has the right to appeal against a decision on voluntary departure within eight (8) days from the day of acceptance of the voluntary departure decision to the Appeals Commission.</p> <p>2. The Appeals Commission shall examine the appeal within fifteen (15) days from the day of its acceptance. The appeal against the decision for voluntary departure shall suspend the enforcement of the decision.</p> <p>3. The Commission shall resolve the case within the time limit of fifteen (15) days from the day of receipt of the appeal. An appeal against a decision on voluntary leave suspends</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Pravo na žalbu</p> <p>1. Stranac ima pravo žalbe protiv Odluke o dobrovoljnom odlasku u roku od osam (8) dana od dana prijema odluke o dobrovoljnom odlasku u Komisiji za žalbe.</p> <p>2. Komisija razmatra žalbu u roku od petnaest (15) dana od dana prijema iste. Žalba protiv odluke o dobrovoljnom odlasku obustavlja izvršenje odluke.</p> <p>3. Komisija treba da reši pitanje u roku od petnaest (15) dana od dana prijema žalbe. Žalba protiv odluke o dobrovoljnom odlasku obustavlja izvršenje odluke o dobrovoljnom</p>

